

TRAJTIMI I DIS PROBLEMEVE TË GJU ËS DHE LET ISË NË SHKOLLË NË KO FERENCËN II TË STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

Në 2 mars të këtij viti, në një nga sallat e pallatit të madh të kulturës në Tiranë, u hap Konferenca e dytë kombëtare e studimeve pedagogjike, e organizuar nga Instituti i studimeve pedagogjike, në kuadrin e 7 Marsit, ditës së mësuesit.

Konferenca ua kushtoi punimet e saj problemeve të revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës, punës këmbëngulëse që është bërë dhe që duhet të bëhet për të vënë në jetë vendimet e Plenumit të 8-të të Komitetit Qëndror të Partisë dhe Kongresit të 6-të të Partisë në fushën e arësimit dhe të edukimit komunist të brezit të ri. Në këtë Konferencë u përgjithësua përvoja e punës së efektshme për zgjidhjen e problemeve që preokupojnë shkollën në të ardhshmen.

Në Konferencën e dytë kombëtare të studimeve pedagogjike merrnin pjesë punonjës të shkencave pedagogjike,

mësues e kuadro të arësimit nga rrethet e ndryshme të vendit, pedagogë të Universitetit shtetëror të Tiranës dhe të instituteve të larta të vendit, drejtues nga ndërmarrje ekonomike e institucione të ndryshme dhe të ftuar të tjerë.

Ndodheshin, gjithashtu, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qëndror të Partisë Ramiz Alla, sekretar i Komitetit të Partisë të rrethit të Tiranës Fadil Paçrami dhe shokë të tjerë.

Në Konferencë merrnin pjesë edhe përfaqësues të Institucioneve arsimore të Kosovës, nga shkolla e lartë pedagogjike e Prishtinës, nga shkolla e lartë pedagogjike e Gjakovës dhe nga gazeta «Shkëndia».

Ministri i arësimit e kulturës Tho-

ma Deliana e deklaroi Konferencën të hapur; pastaj, sipas programit të ditës së parë, u mbajt seanca plenare.

Ditën e dytë, në datën 3 mars, Konferenca i vazhdoi punimet nëpër 15 seksione të veçantë, sikurse ishin: seksioni i gjuhës e letërsisë, i pedagogjisë dhe psikologjisë, i punës edukative, i arësimit politeknik dhe i punës prodhuese, i edukimit fizik e ushtarak, i kualifikimit të mëtejshëm të kuadrit arësitor, i historikut të shkollës dhe i mendimit pedagogjik shqiptar etj.

Në këto seksione u mbajtën rreth 170 kumtesa, nëpërmjet të cilave u hodhën hapa të reja drejt një perspektive të re për zbatimin e orientimeve që shtroi Partia përpara shkollës sonë në Kongresin e 6-të të saj dhe për forcimin e rrugës shkencore në të cilën do të ecet për t'i vënë në jetë sa më mirë këto orientime.

* * *

Seksioni i gjuhës dhe letërsisë i zhvilloi punimet pas seancës së parë plenare, në një nga sallat e Pallatit të pionierëve. Në të merrnin pjesë mësues nga rrethe të ndryshme të vendit, metodistë e punonjës të tjerë të arësimit. Asistonin, gjithashtu, drejtori i Institutit të studimeve pedagogjike, Nos Josifi, drejtori i Institutit të gjuhësisë e letërsisë, Androkli Kostallari, si dhe Memduh Begolli, drejtor i shkollës së lartë pedagogjike të Prishtinës, Besim Bokshi, drejtor i shkollës së lartë pedagogjike të Gjakovës, Isuf Selimi, redaktor i gazetës «Shkëndia», të cilët u ftuan në Konferencë nga Instituti i studimeve pedagogjike dhe redaksia e gazetës «Mësuesi», e të tjerë.

Në seksionin e gjuhës dhe të letërsisë u mbajtën 15 kumtesa me karakter pedagogjik e metodik, të cilat zgjuan interes ndër të gjithë të pranishmit.

Mbas kumtesave u bënë edhe diskutime. Prej këtyre është për t'u përmendur diskutimi i mësuesit *Naim Plaku* me temë *Probleme të gjuhës letrare në shkollë dhe puna e mësuesit për kristalizimin e saj në luftë me influencat nëndialektale*.

Kumtesat e këtij seksioni ishin në përgjithësi të përgatitura mirë, me tematikë të larmishme, që përfshinte një sërë problemesh preokupantë për shkollën tonë sot.

Disa mendime e përfundime për një formim më të mirë gjuhësor të nxënësve, kështu titullohej kumtesa e një grupi bashkëpunëtorësh të përbërë nga *Engjëll Angoni*, kryespecialist në Ministrinë e arësimit e të kulturës dhe nga *Paulina Tërpini* e *Lutfe Çela*, mësuese në Vlorë. Në këtë kumtesë autorët dhanë mendime dhe treguan disa përfundime që kanë arritur në punën për një formim më të mirë gjuhësor të nxënësve, në radhë të parë nëpërmjet konkurseve gjuhësore dhe në radhë të dytë me anë të rrethit të gjuhëtarëve të vegjël në shkollat 8-vjeçare, të mbështetur kryesisht në përvojën pozitive që kanë në këtë drejtim disa prej shkollave të këtij rrethi.

Kumtesa në fjalë shtjellonte problemin e organizimit të këtyre formave dhe arësytet përse ato gjetën zbatim të frutshëm në praktikë.

Skënder Hallva lexoi në seksionin e gjuhës e letërsisë kumtesën *Mendime për përsosjen e orës së mësimi si njësi metodike*. Ai e kishte përgatitur atë i mbështetur në punën eksperimentale të zhvilluar në shkollën 8-vjeçare të Belshit-Elbasan. Kumtesa e tij lëshonte idenë që mësuesi mund ta ndërtojë edhe më mirë punën e vet mësimore në lëndën e gjuhës shqipe, duke përcaktuar si njësi metodike jo një temë të veçantë, por një kapitull ose një grup temash të përafërta. Kështu, ai mund të sigurojë një sërë avantazhesh për një përvetësim më të shpejtë të njohurive gjuhësore nga ana e nxënësve dhe për edukimin më mirë

dhe më saktë tek ata të shprehive të nevojshme praktike.

Mësuesja *Hedie Muçaj*, e shkollës «Hydajet Lezha», duke referuar mbi kumtesën *Përfundime rreth përsosjes së mëtejshme të mësimdhënjes në lëndën e gjuhës shqipe*, pruri në këtë seksion përvojën e vet për zbatimin e disa formave metodike, që e gjallërojnë mësimin e gjuhës dhe që e bëjnë atë sa më aktiv. Në këto forma ajo nënvizonte metodën e analizës krahasuese, diskutimin mësimor, recensio-nimin e punëve me shkrim nga nxënësit, si edhe aksionin mësimor për kulturën e të folurit.

Punët e pavarura gjuhësore për zhvillimin e të menduarit logjik të nxënësve, ky ishte titulli që mbante kumtesa e mësuesit *Gëzim Begolli* nga shkolla 8-vjeçare e Bitinckës në rrethin e Korçës. Në kumtesë jepeshin forma të ndryshme pune, që ai kish zbatuar për të zhvilluar mendimin logjik të nxënësve rreth njohurive të reja gjatë etapave të veçanta të orës së mësimi. Ndonëse format që përmëndte autori i mësipërm tingëllojnë shumë a pak si të njohura, luajnë rol pozitiv, në qoftë se përdoren në mënyrë krijuese nga ana e mësuesit.

Me interesim u prit në këtë seksion kumtesa *Shtrirja e punës me ortografinë në tërë procesin mësimor të gjuhës* e punonjësit të Institutit të studimeve pedagogjike, *Kiço Kosta*. Problemi i përvetësimit sa më të shëndoshë të njohurive ortografike nga ana e nxënësve dhe edukimi ndër ta i shprehive të drejtshkrimit përbënin një nga problemet më themelore të kësaj kumtese. Ky problem trajtohej, duke u theksuar si një nga çështjet më të mprehta të mësimi të gjuhës në shkollat tona sot, prandaj edhe për ta prekur atë sa më realisht e sa më shkencërisht, ishte shfrytëzuar përvoja e mjaft mësuesve në këtë drejtim dhe studime të tjera të specialistëve të gjuhësisë. Së pari, autori i jepte rëndësi domosdoshmërisë së lidhjes së punës me ortografinë me punën për ortoepinë; së dyti, nënvizonte rolin e madh

që luajnë për një drejtshkrim sa më saktë shfrytëzimi drejt dhe në masën e duhur i mjeteve të konkretizimit etj.

Për mësuesin e leximit letrar është veçanërisht e nevojshme që ai të përcaktojë mirë kriteret, sipas të cilave nxënësit të gjykojnë mbi personazhet e veprave letrare. Kështu ata pregatiten për lexime të pavarura, fitojnë aftësi të sakta për t'i vlerësuar drejt librat, për të bërë analizën e tyre në vështrim të njërit apo të tjetrit personazh etj. Duke u nisur nga ky qëllim, mësuesi i leximit letrar zhvillon në klasë punë të mjaftueshme me karakter metodik. Pikërisht këto probleme trajtonte në kumtesën e vet *Kriteret ideo-metodike për analizën e personazhit drejtori i kabinetit pedagogjik të Fierit, Kristaq Shtëmbari*. Mbasi foli në përgjithësi rreth këtyre problemeve, ai vuri në dukje dy çështje që duhet të mbahen parasysh nga mësuesi për analizën e personazheve: 1. Përcaktimi drejt prej tij i asaj që duhet të dijë nxënësi dhe 2. Përcaktimi i asaj që duhet të marrë nga mësuesi në orën e leximit.

Fjala hyrëse e mësuesit — element i rëndësishëm në procesin mësimor të leximit letrar ishte kumtesa që u mbajt nga mësuesi Remzi Zeqja i shkollës së Kamzës në rrethin e Tiranës. Në këtë kumtesë ai theksoi se çfarë duhet ta karakterizojë fjalën hyrëse, si duhet të jetë ajo nga forma dhe përmbajtja etj. Shpjegimet dhe shëmbujt e dhënë nga autori ishin të qartë dhe të pasur. Në përgjithësi kumtesa e tij ish e rrjedhshme dhe mund të thuhet ia kish arritur qëllimit të caktuar.

Bekim Harxhi, mësues në Gjirokastrë, referoi në seksion kumtesën *Mësimi i letërsisë dhe edukimi fizik e ushtarak i nxënësve*. Qëllimi i tij ishte që të jepte disa pika takimi në përmbajtjen e mësimi të letërsisë dhe atij fizik e ushtarak në shkollat e mesme, për t'u thelluar edhe më shumë në edukimin ideo-politik të nxënësve. Duke prurë shëmbuj që nga letërsia e vjetër shqipe e gjer tek ajo e realizmit socialist, po kështu edhe nga folklori

ynë, ai vuri në dukje se mësuesit i krijohet një mundësi e madhe për të realizuar lidhjen e këtyre dy mësimëve me metodën e analizës klasore të trajtimit të ngjarjeve dhe të fenomeneve shoqërore. Veç këtyre, referuesi i dha rëndësi zbrërthimit të koncepteve që ndeshen në materialin letrar e që lidhen drejtpërsëdrejti me tezat e parimet marksiste-leniniste të Partisë sonë. Ai përcaktoi disa nga problemet në të cilat takohet letërsia me edukimin fizik e ushtarak: në çështjet e luftës dhe të paqes, në karakterin e luftrave (të drejta e të padrejta), në domosdoshmërinë për t'u edukuar fizikisht e ushtarakisht i gjithë populli, në përgatitjen për metodën e luftës popullore, në trajtimin e brezit të ri si forcë e madhe për mbrojtjen e Atdheut etj.

Edukimi i nxënësve me të bukurën bëhet vetëm nëpërmjet analizës me sy kritik të përmbajtjes e të formës së veprës letrare në të gjitha etapat e mësimin të letërsisë. Ky ishte problemi që trajtonte mësuesi *Nexhat Hakiu* në kumtesën *Edukimi ideo-estetik përmes letërsisë*. Në vazhdim të kumtesës ai shprehu mendimin se do të jetë diçka e mirë në se në të ardhshmen do të shtohen edhe më shumë tabllo nga jeta e gjallë heroike e masave tona punonjëse, pejsazhe frymëzuese pune, natyrë shqiptare etj., të cilat patjetër do ta edukojnë nxënësin e shkollës 8-vjeçare ose të mesme me shijen e së bukurës revolucionare, të realizuar nga populli nën udhëheqjen dritëdhënëse të Partisë sonë.

Kumtesën *Forma të reja metodike në mësimin e leximit letrar* e mbajti në seksionin e gjuhës e të letërsisë mësuesja e shkollës 8-vjeçare të Lezhës, *Ferial Resuli*. Duke u mbështetur në punën e saj kërkimore për përsosjen edhe revolucionarizimin e mëtejshëm të procesit mësimor, ajo dha disa forma pune të përdorura në lexim, të cilat kanë siguruar përfundime të mira në shkollën e mësipërme.

Qazim Kashari, metodist në Ministrinë e arësimit e të kulturës, u paraqit

me kumtesën *Leximi i pavarur i letërsisë artistike nga nxënësit — proces i drejtuar nga mësuesi*. Për përgatitjen e kësaj kumtese ai ishte mbështetur në të dhënat e anketave të organizuara në shkolla të ndryshme të vendit, si në qytete po ashtu edhe në fshatra; prej këtyre anketave ai kish nxjerrë konkluzione përgjithësuese rreth disa problemeve: çfarë lexojmë më shumë nxënësit, sa e shfrytëzojnë ata kohën e lirë për këto lexime, përse është e nevojshme udhëheqja e këtyre leximeve nga ana e mësuesit, etj. Problemin autori e trajtonte jo vetëm thjesht nga pikëpamja pedagogjike-shkencore, por edhe nga ajo psikologjike, gjë e cila përbënte një meritë të veçantë të kësaj kumtese.

I dobishëm për lëndën e letërsisë në shkollën 8-vjeçare ishte edhe punimi *Rrugët metodike për forcimin e boshtit ideologjik në leximin letrar* i pedagogut të Institutit të lartë pedagogjik të Shkodrës, *Faik Luli*. Me punimin e vet autori kish për qëllim të përcaktonte rrugë të efektshme metodike për edukimin ideopolitik në masën e nxënësve, sikurse është planifikimi i lëndës, i cili duhet bërë duke pasur parasysh karakterin ideotamatik të pjesëve letrare në përgjithësi dhe në disa raste atë kronologjik. Parashikimi i pjesëve letrare për analizë, — theksoi ky autor, — është e domosdoshme të përputhet me ngjarjet e shënuara lokale e kombëtare, me problemet shoqërore që lindin kohë pas kohe e me praktikën revolucionare të jetës sonë. Edukimi ideopolitik i nxënësve vazhdoi ai, bëhet edhe nëpërmjet gërshetimit të pjesëve të leximit me nëndarjet e tjera të programit, siç janë orët e bisedave letrare, të referateve, orët për zhvillimin e të folurit e të punëve me shkrim etj.

Çështje përafërsisht të njëjta trajtonte në kumtesën e vet me titull *Leximi letrar dhe formimi ideopolitik e moral i të riut tonë* edhe mësuesi *Sabaudin Harja* nga Elbasani. Theksin ai e vuri veçanërisht në nevojën e zhvillimit të temave sipas problematikës, që për-

